



AKT - THEMELIMI

I

SHOQERISE "Areco" SH.P.K.

Ne Tirane, sot me date 08.Shtator 1999 (nentedhjeteente),
une Drita Cara e bija i Ibrahimit dhe i Hanes , i datelindjes
16.03.1963 , lindur ne Kurbnesh dhe banues ne Tirane ne Rrugen
"Hoxha Tasim , pallati 25 shkalla 1 apartamenti 1 Tirane,
madhore , me zotesi te plote juridike, ne mbeshtetje te Ligjit
Nr. 7638 date 19.11.1992 " Per Shoqerite Tregtare" dhe te Ligjit
Nr. 7667 Date 28.1.1993 " Per rregjistrin Tregtar dhe
formalitetet qe duhen respektuar ne te " .

VENDOSA:

NENI 1

Te themeloje nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar te
emeruar " Areco " Sh.P.K. Tirane.

NENI 2

Selia e shoqerise do te jete ne Tirane, ne Rrugen "Hoxha
Tasim" Pallati 29 Shkalla 1, Apartamenti 3 .

NENI 3

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete:

- Te ushtroje veprimtari private ne sferen e import eksport,
tregti me shumice e pakice te artikujve te ndryshem te te gjitha
llojeve, ushqimore e industriale, si pajisje elektronike e
elektro- shtepiake, materiale ndertimi, elektrike, mobilje ,
kancelari, pije alkoolike, konfeksione, bime mjeksore etj.
- Tregtim te lendeve djegese, si dru zjarri, gaz te lenget etj.
- Tregtim buke si dhe produkte te tjera bujqesore e blegtorale
etj.
- Tregtim e prodhime te duraluminit.

NENI 4

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke dhe eshte
prone e ortakut te vetem te shoqerise, krijuesit te saj zonjes
Drita CARA.

NENI 5

Kohë të zgjatja e veprimtarisë së shoqërisë do të jetë mbi 10 vjet të njëpasnjëshem. Por ajo mund t'a pushojë veprimtarinë e saj edhe përpara kësaj afati në rastet e parashikuara në statutin e shoqërisë.

NENI 6

Shoqëria "ARECO" Sh.P.K. Tiranë do të përfaqësohet nga ortakët i vetëm i saj që është njëkohësisht edhe administratorë të shoqërisë zënjë Drita CARA si dhe nga personat e autorizuar prej saj.

Neni 7

Veprimtarinë e saj shoqëria do të zhvillojë në përputhje me Legjislativonin Shqiptar dhe Statutin e hartuar për këtë qëllim.

Neni 8


Ndryshimet në këtë akt themelimi do të bëhen në të njëjtën mënyrë dhe procedurë në të cilën nxirret akt themelimi.

Akt Themelimi nënshkruhet rregullisht nga ortakët i vetëm të shoqërisë.

ORTAKU I VETEM I SH.P.K. "ARECO"

DRITA CARA

REPUBLIKA E SHQIPËRISE
DHOMA E NOTERISE TIRANË.
Nr. Rep..2441




V E R T E T I M .

Sot në Tiranë, me datë 8 Shtator 1999 në zyrën e noterisë Tiranë, u paraqit kërkesja Drita Cara, e njohur personalisht prej meje, madhore, me zotësi të plote juridike për të vepruar, e cila deklaroi se sa sipër jashtë kësaj zyre, ka bërë një Akt - Themelimi dhe pasi e nënshkroi rregullisht, unë noteri e vertetoj sipas ligjit.

N O T E R I

Nezir Murati





STATUTI

I

SHOQERISE " ARECO " SH.P.K.

FORMIMI

NENI 1

Formohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar e emeruar "ARECO" SH.P.K. TIRANE me ortakun e saj te vetem zonjen Drita Cara e bija i Ibrahimit dhe e Hanes, datelindjes 16.03.1963 lindur ne Kurbnesh dhe banuese ne Tirane ne Rrugen "Hoxha Tasim" Lagja Nr.4 Pallati 25 , ap.1 me zotesi te plote juridike, per te vepruar.

SELIA

NENI 2

Selia e shoqerise do te jete ne Rrugen "Hoxha Tasim" Pallati 29, Shk.1, Apartamenti 3 Tirane.

Shoqeria mund te hape edhe vend qendrim te tjera te dyja operative, perfaqesi dhe axhensi ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi te vendit ku ato hapen dhe me miratimin e organeve perkatese kompetente.

KOHE - ZGJATJA

NENI 3

Kohe-zgjatja e veprimtarise se shoqerise do te jete mbi 10 vjet te njepasnjeshem. Por ajo mund te pushoje veprimtarine e saj edhe perpara ketij afati ne rastet e parashikuara ne kete statut.

OBJEKTI

NENI 4

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete:

- Tregtimi i ushtrroje veprimtari private ne sferen e import eksport, tregtimi me shumice e pakice te artikujve te ndryshem te te gjitha llojeve ushqimore e industriale, si pajisje elektronike e elektroshtepijake , materiale ndertimi, elektrike, mobilje kancelari, pije alkoolike, konfeksione bime mjeksore etj.
- Tregtim lendesh djegese, si dru zjarri, gaz te lenget etj.
- Tregtim buke si dhe produkte te tjera bujqesore e blegtorale.
- Tregtim dhe prodhime te duraluminit.

NENI 5

Shoqeria mund te ndryshoje emertimin, seline dhe objektin e veprimtarise se saj sipas vendimeve qe do te marre ortaku i vetem i shoqerise.

KAPITALI THEMELTAR

NENI 6

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke dhe eshte vene nga ortaku i vetem i shoqerise.

Kapitali mund te shtohet me deshiren dhe sipas vendimeve qe do te marre ortaku i vetem i shoqerise, shtese qe mund te behet ne vlere ose ne natyre.

Kapitali mund te transferohet ose te lihet peng sipas dispozitave ne fuqi. Ai mund te transferohet ne rruge trashegimie, bashkeshortit, pasardhesit mund te behen ortake te shoqerise nepermjet transferimit te pjeseve te kapitalit themeltar.

NENI 7

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te ketij statuti si dhe ato te legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Shoqeria fiton zotesine per te vepruar me rregjistrimin e saj ne Gjykatën e rrethit Tirane, si person juridik ne rregjistrin e saj tregtar, ndersa e ushtron aktivitetin e saj ekonomik tregtar privat me rregjistrimin e saj ne organet tatimore .



DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI.

NENI 8

Shoqeria "ARECO" Tirane eshte prone e ortakut te vetem te shoqerise, themelueses se saj zj. Drita CARA, e cila drejton veprimtarine ekonomike te saj, duke u mbeshtetur ne te drejten e pronesise private dhe te mjeteve te investuara ne shoqeri.

Administratore e shoqerise do te jete zj. Drita CARA.

NENI 9

Shoqeria merr persiper te drejttat dhe detyrimet, kjo vepron me te drejten e saj te pronesise private. Ajo pergjigjet vete per detyrimet e saj kontraktore dhe jashte kontraktore, brenda kapitalit te saj, Ortaku i vetem i shoqerise ka te mbartur rrezikun per veprimtarine ekonomike te shoqerise ne nivelin e shumes se mjeteve kryesore te investuara ne kapitalin e shoqerise.

NENI 10

Ortaku i vetem i shoqerise ne baze te vendimeve qe merr emerom administratore dhe puneson punonjes te aktiviteteve te ndryshme qe i nevojiten shoqerise.

NENI 11

Ortaku i vetem i shoqerise dhe administratoret e emeruar prej tij jane te veshur me te gjitha fuqite per drejtimin e zakonshem dhe te jashtezakonshem te shoqerise, pa asnje perjashtim dhe kufizim, me perjashtim te kompetencave qe ligji ia jep shprehimisht ortakut te vetem te shoqerise.

Administratoret e emeruar mund te kryejne veprime ne emer te shoqerise, ne marredhenie me te tretet administratoret veprojne ne emer te shoqerise ne te gjitha rrethanat. Ata kane te drejte qe te kryejne te gjitha aktet qe konsiderohen te nevojshme per aritjen e qellimeve te fitimit te shoqerise.

Administratoret kane te drejte qe te kryejne veprime prane te gjitha zyrave shteterore dhe private, qe kane te bejne me garancite dhe veprimet bankare.

Ne te tilla raste administratori i emeruar (autorizuar) eshte i detyruar qe te njoftoje dhe te jape llogari perpara ortakut te vetem te shoqerise.

Shoqeria merr persiper detyrimet qe rrjedhin nga aktet e administratoreve te shoqerise dhe kur keto akte nuk perfshihen ne aktin e shoqerise. Ajo merr persiper pasojat ndaj te treteve edhe kur keto te fundit e dinin se akti i administrimit e kalonte objektin e shoqerise, ose kur te tretet nuk mund t'ja injoronin kete akt ne rrethanat e dhena.

MAREDHENIET E PUNES

NENI 12

Maredheniet e punes ne Shoqeri rregullohen nepermjet dispozitave te Kodit te punes te Republikes se Shqiperise. Te gjithe personat e punesuar ne shoqeri "ARECO" Sh.P.K. kane te drejte t'i percaktojne maredheniet e punes ne kete shoqeri nepermjet kontrates se punes.

NENI 13

Mosmareveshjet e te punesuarve ne shoqeri zgjidhen nga gjykata Shqiptare. Kur pala ankuese eshte person i huaj mosmareveshjet zgjidhen nga organi qe percaktohet ne kodin e punes.

NENI 14

Shoqeria respekton rregullat e punesimit dhe te sigurimeve shoqerore, kurse te punesuarit jane te detyruar qe te pranojne dhe te zbatojne rregullat e ketij statuti. Administratori i emeruar (autorizuar) nuk mund te marre cilesine e ortakut te shoqerise dhe as te ushtroje aktivitet kontraktor te cfaredo lloji per llogari te tij ose te te treteve.

Per cdo shkelje ne kete drejtim ai pergjigjet sipas dispozitave ne fuqi. Te gjithe te punesuarit ne shoqeri jane te detyruar te ruajne sekretin e punes. Sekret pune paraqesin shkresat materiale, te dhenat informative, si dhe vendimet e nxjerra nga ortaku i vetem i shoqerise, qe u jepen organeve shteterore perkatese te miratuara dhe te nenshkruara nga ortaku i vetem i shoqerise.

NENI 15

Perfaqesuesi i shoqerise "ARECO" SH.P.K. Tirane i perket ortakut te vetem te shoqerise, qe eshte njekohesisht edhe administratore e saj zj. DRITA CARA, si dhe personave te autorizuar prej saj. Ata kane te drejte qe te perfaqesojne shoqerine ne organet gjyqesore dhe ne gjykime, te caktojne dhe te pushojne avokate per ceshtje ne gjykim.

NENI 16

Gjithe veprimtaria ekonomike e shoqerise drejtohet nga ortaku i vetem i saj zj.DRITA CARA, e cila qeveris gjithë aktivitetin e saj. Ajo vendos per pjesmarrjen e shoqerise ne shoqeri te tjera brenda dhe jashte vendit, (vendase ose te huaja), te ndryshoje dhe te plotesoje statutin e shoqerise, te miratoje bilancet vjetore dhe periodike te shoqerise te vleresuara nga organi i saj financiar, te vendose per shperberjen

e shoqerise, te percaktoje politiken eknomike te shoqerise, pranimin e ortakeve te rinj ne shoqeri, per shtimin ose pakesimin e kapitalit ne vlera ose ne natyre dhe te tjera.



EKSPERTI KONTABEL

NENI 17

Ortaku i vetem i shoqerise cakton edhe ekspert kontabel, qe te kontrolloje aktivitetin e saj financiar, arken dhe rregjistrin e veprimeve kontabel te shoqerise, si dhe te pergatise raportin perkates.

BILANCI DHE TE ARDHURAT

NENI 18

Shoqeria "ARECO" SH.P.K. Tirane, çel llogarine e saj rrjedhese ne nje banke shqiptare. Veprimet ekonomike te shoqerise mbyllen ne fund te cdo viti, me date 31 dhjetor. Ne fund te cdo periudhe nxirret bilanci kontabel qe miratohet nga ortaku i vetem i shoqerise.

Shoqeria percakton fondet si me poshte:

- fondi themeltar (qarkullues)
- fondi rezerve
- fonde te tjera te cilat mund te jene te nevojshme gjate veprimtarise se shoqerise.

Masa e secilit fond dhe menytrat e perdorimit te tij percaktohen me vendim te ortakut te vetem, sipas dispozitave specifike te parashikuara ne ligjin "Per shoqerite tregtare".

ÇMIMET

NENI 19

Aktivitetin e saj shoqeria do t'a zhvilloje kundrejt cmimeve sipas kerkeses dhe ofertes, me perjashtim te çmimeve te vendosura nga qeveria.

MBARIMI I SHOQERISE

NENI 20

Veprimtaria e shoqerise mbaron me vendim te arsyetuar te Oratakut te vetem ne rastet e parashikuara ne ligj.

NENI 21

LIKUJDIMI I SHOQERISE.

1. Kur shpërndahehet shoqeria per cdo lloj arsyeje, pervec falimentimit, ndiqet rregulli i likujdimit. Gjersa te kryhet ky veprim qohet se vazhdon funksionimi i shoqerise. Shoqeria mban emrin e saj ne te cilen shtohet fjala "Ne likujdim e siper" duke bere veprimet e duhura ne rregjistrin tregtar prane Gjykates se Rrethit Tirane.

2. Likujdimi i shoqerise vendoset me vendim te arsyetuar te Ortakut te Vetem. Ortaku i vetem per te kryer veprime likujdimi emerone nje likujdator me tagrat e percaktuar ne ligjin "Per shoqerite tregtare".

3. Likujdatori i emeruar eshte pergjegjes si ndaj shoqerise ashtu dhe ndaj te treteve per pasojat dempruresse te gabimeve qe ai ka bere gjate ushtrimit te funksioneve te tij. Likujdatori i emeruar shperblehet ne menyren me te cilen vendos ortaku i vetem i shoqerise.

4. Likujdatori i emeruar perfageson shoqerine dhe nenshkruan duke vene firmen poshte vules se shoqerise. Ai duhet te perfundoje shitjet qe jane te diskutueshme per llogari te shoqerise. Ai duhet te marre nga cdo debitor llogari te sakta ne monedhe dhe te ktheje pasurine e shoqerise ne para. Per ceshtjet qe kane mbetur pezull administratori i shoqerise (Ortaku i vetem) ka te drejte te vendose per zgjidhjen e tyre.

5. Ne perfundim te likujdimit likujdatori detyrohet te perpiloje bilancin perfundimtar dhe te nxjere buletinin.

DISPOZITA TE PERGJITHESHME.

NENI 22

Persa nuk eshte shprehur plotesisht ne kete statut i referohet plotesimeve qe do te te beje ortaku i vetem i shoqerise si dhe me ligje te vecanta.

Ndryshimet dhe plotesimet ne kete statut do te behen ne te njejtej menyre dhe procedure ne te cilen nxirret statuti.

Statuti nenshkruhet rregullisht nga ortaku i vetem i shoqerise.

ORTAKU I VETEM I SH.P.K. " ARECO "

DRITA CARA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Nr.Rep...2442

VERTETIM.

Sot ne Tirane , me date 8.Shtator 1999 ne zyren e noterise Tirane, u paraqit kerkuesja Drita Cara, e njohur personalisht prej meje, madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar, e cila deklaroi se sa siper jashte kesaj zyre, ka bere nje Statut dhe pasi nenshkroi rregullisht, une noteri e vertetoj sipas ligjit.

NOTERI

Nezir Marati

